



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1249/prot.
12

Tiranë më 13.10 2017

REKOMANDIM

Nr. 45, datë 13.10 .2017

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Baza Ligjore: Ligji Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nenet 30, 31 dhe 32 të tij.

Në zbatim të Urdhrit Nr.232, datë 15.09.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Pelikani Security" sh.p.k Tiranë, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "Pelikani Security" sh.p.k. Tiranë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrit Nr.232, datë 15.09.2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi "Pelikani Security" sh.p.k. Tiranë, është subjekt juridik me NIPT: K11423005T, me objekt aktiviteti, sigurimi i objekteve publike dhe private në pronësi ose në përdorim të personave fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, sigurimin dhe mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të personave fizik, shtetas shqiptar dhe të huaj.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim u konstatua:

1. Kontrolluesi e ka kryer "Njoftimin" pranë Zyrës së Komisionerit, por konstatohet se është i nevojshëm përditësimi i tij, pasi nuk janë deklaruar në mënyrë të plotë dhe të saktë informacionet në lidhje me adresën e kontrolluesit, të dhënat sensitive që përpunohen dhe pasaktësi në rubrikën mbi përhapjen e të dhënave.

Konstatimi i pikës së parë, përbën shkelje administrative të nenit 22 dhe 23 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, i cili shprehet:

"1. Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë".

2. Kontrolluesi ka hartuar rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale dhe ka nënshkruar "Deklaratë Konfidencialiteti" me punëmarrësit të cilët kanë akses në sistemet elektronike si dhe të dhënat personale që disponon kompania, por nuk ka hartuar një rregullore për funksionimin e sistemit të vëzhgimit (CCTV), ndërkohë që kontrolluesi disponon 120 kamera vëzhguese aktive.

Konstatimi i pikës së dytë, përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, i cili shprehet:

"1. Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

2. Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:

2/1. Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera".

3. Kontrolluesi mbikëqyr ambientet e brendshme dhe të jashtme të godinës në të cilën ushtron aktivitetet, nëpërmjet sistemit të video-survejitimit. Në zyrat e administratës së kontrolluesit, ka kamera vëzhgimi, për të cilat është marrë pëlqimi i punonjësve, por kjo çmohet e tepërt, parë në frymën e ligjit dhe akteve ndërkombëtare mbi privatësinë.

Zyra e Komisionerit, në respekt të Udhëzimit Nr.3, 05.03.2010 pika 2 (*"Një e dhënë personale në tërësinë e saj përbëhet nga ata faktorë identifikues që bëjnë të mundur lidhjen e një personi të caktuar me një sjellje të kapur nga një sistem survejimi*), pika 4, geramat "a" dhe "f" mbi "Përpunimin e të Dhënave Personale me sistemin e video survejitimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" shprehet:

4. Detyrimet e një kontrolluesi i cili operon me një sistem të video survejitimit, janë:

a) Sistemi i video survejitimit nuk duhet të ndërhyjë në jetën private të individëve.

Përpunimi i të dhënave me anë të një sistemi video survejimi mund të lejohet vetëm nëse qëllimi për të cilin është instaluar ky sistem nuk mund të arrihet në një mënyrë tjetër.

Instalimi i një sistemi video survejimi është i ndaluar në dhoma që përdoren ekskluzivisht për qëllime private si tualete, dushe, zhveshje.

f) Instalimi dhe përdorimi i sistemit të video survejimit duhet të bëhet në atë formë që përpunimi i të dhënave të kryhet në përputhje me të drejtat themelore të njeriut, të drejtën për privatësi dhe të drejtën për jetë private dhe familjare. *Këto të drejta janë të mbrojtura nga neni 8 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut i miratuar me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, si dhe me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*“.

Koha e ruajtjes së të dhënave në sistem është 60 (gjashtëdhjetë) ditë. Kontrolluesi ka vendosur tabela informuese sipas standardit të kërkuar nga Komisioneri, në hyrje të ambienteve ku ushtron aktivitetin e tij.

Konstatimi i pikës së tretë, përbën shkelje administrative të neneve 5 dhe 6 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, ky i fundit shprehet: *1. Të dhënat personale përpunohen vetëm:*

a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin;

b) nëse përpunimi është thelbësor për përmbushjen e një kontrate, për të cilën subjekti i të dhënave është palë kontraktuese, apo për diskutime ose ndryshime të një projekti/kontrate me propozimin e subjektit të të dhënave;

c) për të mbrojtur interesat jetikë të subjektit të të dhënave;

ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit;

d) për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;

dh) nëse është thelbësor për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitime të kontrolluesit, marrësit apo personave të tjerë të interesuar. Por, në çdo rast, përpunimi i të dhënave nuk mund të jetë në kundërshtim të hapur me të drejtën e subjektit të të dhënave për mbrojtjen e jetës personale dhe private.

4. Kontrolluesi mbikëqyr lëvizjen e mjeteve motorike të kompanisë nëpërmjet sistemit të gjco-lokalizimit GPS dhe informon punëmarrësit nëpërmjet aktit të marrjes në dorëzim të këtyre mjeteve.

Nga verifikimi i faqes zyrtare të kontrolluesit, <http://www.pelikani-security.al>, u konstatua se rubrika “*Politikat e privatësisë*” nuk ishte e plotë. Mungojnë rubrika informuese, të tilla si:

- Si i përdor kompania të dhënat e subjekteve të të dhënave.
- Personat që paraqesin një ankesë pranë “*Pelikan Security*” sh.p.k.
- Personat të cilët përdorin shërbimet e “*Pelikan Security*” sh.p.k.
- Vizitorët e faqes së internetit të “*Pelikan Security*” sh.p.k.
- Aplikantët për punë, të punësuarit aktualë dhe ish të punësuarit pranë “*Pelikan Security*” sh.p.k.
- Aksesi në të dhënat personale.
- Përhapja e të dhënave personale.

- Lidhjet me faqet e tjera nëse ka.
- Politika e sigurisë së informacionit etj.

Ky informacion i publikuar në *"Politikat e Privatësisë"*, ka për qëllim informimin e plotë të subjekteve të të dhënave që vizitojnë portalin, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e tyre dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Konstatimi i kësaj pike, përbën shkelje administrative të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar, i cili shprehet:

"1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij.

2. Në rast se kontrolluesi përpunon të dhëna personale, të marra nga subjekti i të dhënave, ai është i detyruar të informojë subjektin e të dhënave nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare. Nëse subjekti i të dhënave, në bazë të një akti ligjor ose nënligjor, është i detyruar të japë të dhëna personale për përpunim, kontrolluesi e informon edhe rreth këtij fakti, si dhe rreth pasojave të refuzimit të dhënies së të dhënave personale".

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 5 dhe 6 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, kontrolluesi *"Pelikan Security"* sh.p.k. Tiranë, të rishikojë kushtet për heqjen e kamerave të sigurisë në zyrat e administratës duke vendosur masa të tjera sigurie, pa cënuar interesat e tij.
2. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, kontrolluesi *"Pelikan Security"* sh.p.k. Tiranë, të plotësojë dhe publikojë në portalin zyrtar të tij, rubrikën *"Politikat e Privatësisë"*.
3. Në zbatim të nenit 22 dhe 23 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, kontrolluesi *"Pelikan Security"* sh.p.k. Tiranë, të realizojë në vazhdimësi përditësimin e Formularit të Njoftimit.
4. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, kontrolluesi *"Pelikan Security"* sh.p.k. Tiranë, të hartojë rregullore për funksionimin e sistemit të vëzhgimit (CCTV).

5. Kontrolluesi "Pelikan Security" sh.p.k. Tiranë, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikat 1, 2, dhe 4, brenda afatit 10 ditor nga momenti i marrjes dijani, e në vazhdimësi përditësimin e njoftimit sipas pikës 3 të këtij Rekomandimi.
6. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 13/10/2017

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

